

**Analizë Gjinore e Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit  
Rural në Komunën e Vitisë**

**DRAFT**

**Nëntor 2023  
UN WOMEN**

## Table of Contents

<b><i>Hyrje</i></b> .....	<b>3</b>
<b><i>Korniza Ligjore</i></b> .....	<b>4</b>
<b><i>Metodologjia</i></b> .....	<b>5</b>
<b><i>Komuna e Vitisë: Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari</i></b> .....	<b>5</b>
<b>Reprezentimi</b> .....	<b>5</b>
<b>Resurset</b> .....	<b>6</b>
<b>Realja</b> .....	<b>8</b>
<b>Realizimi</b> .....	<b>9</b>

DRAFT

## Hyrje

Zhvillimi i bujqësisë vazhdon të ketë rëndësi të madhe për ekonomikë e vendit duke kontribuar në zhvillim rural, punësim, prodhim të ushqimit, e të tjera. Andaj, për zhvillim të qëndrueshem ekonomik është shumë me rëndësi që të gjithë, gratë dhe burrat, të jenë pjesë aktive e kësaj ekonomie. Fatkeqësisht, në Kosovë gratë janë të nënpërfaqësuara në ekonominë e agrikulturës, meqë vetëm 4.9% kanë tokë në pronësi të tyre dhe 3% janë gra aktive të punësuara në agrikulturë, peshkim, dhe pylltari. Por, në realitet këto shifra janë shumë më të mëdha sepse gratë punojë në bujqësi pa u regjistruar.<sup>1</sup> Kjo gjendje, sjell në pah rëndësinë e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në nivel lokal, në mënyrë që të ketë fuqizim të grave në agrikulturë dhe pjesmarrje më të madhe të tyre në këtë sektor. Për këtë qëllim, në seksionet më poshtë analizojme se deri në çfarë mase është integruar perspektiva gjinore në sektorin e bujqësisë, në komunën e Vitisë. Pra, sa janë gratë e përfshira në zhvillim të politikave bujqësore, në mekanizma vendimarrës të komunës në lidhje me ndarjen e resurseve në këtë sektor, dhe mundësitë ekonomike e sociale të tyre për përfshirje.

Komuna e Vitisë ka sipërfaqe rreth 1079 ha dhe shtrihet në pjesën fushorë, në qendër të Moravës së epërme nëpër të cilin vendbanim rrjedh Morava e Bincës.<sup>2</sup> Kurse, në nivel të komunës përgjegjëse për zhvillim dhe koordinim të politikave bujqësore është Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Sipas Agjencisë së statistikave kjo komunë ka 46.978 numër të banorëve, nga të cilat 23.287 janë femra dhe 23.700 janë meshkuj, siç mund të shihet në figurën e mëposhtme.

Censusi i Republikës së Kosovës – Regjistrimi 2011		
Republika e Kosovës	Burra	875.900
	Gratë	863.925
	Total	1.739.825
Vitia	Burra	23.700
	Gratë	23.287
	Total	46.987

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës<sup>3</sup>

<sup>1</sup> UN Women. (2021). "In Kosovo, gender-responsive budgeting raises hope for rural women" E qasshme tek <https://eca.unwomen.org/en/neës/stories/2021/10/in-kosovo-gender-responsive-budgeting-raises-hope-for-rural-women>

<sup>2</sup> Plani Rregullues Urban Zonat: Qendra, Jugore dhe Lumi Qyteti i Vitisë <https://kk.rks-gov.net/viti/ep-content/uploads/sites/32/2018/01/Plani-Rregullues-Urban-i-ZQJL-Viti.pdf>

<sup>3</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës. <https://ask.rks-gov.net/media/1613/popullsia-sipas-gjinis%C3%AB-etnicitetit-dhe-vendbanimit.pdf>

## Korniza Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e njeh barazinë gjinore si të drejtë themelore. Konkretisht, artikulli i 15 i Kushtetutës thotë “shteti duhet të garantojë barazinë ndërmjet grave dhe burrave dhe të zhvillojë politika për mundësi të barabarta”. Në fund të vitit 2020, Konventa e Stambollit është bërë pjesë e Kushtetutës së Kosovës përmes votimit të amendamentit nr 26.4, me shumicë votash në parlament. Kjo konventë njihet në botë si instrument ligjor për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe të dhunës në familje, si dhe mbrojtjen e viktimave.

Për më tepër, Kosova ka kornizë ligjore dhe strategjike, si dhe mekanizma institucional në nivel qendror dhe lokal që garantojnë barazinë gjinore. Korniza ligjore përfshinë pakon e ligjeve për barazi gjinore: ligjin kundër diskriminimit, ligjin për Ombudpersonin, dhe ligjin për barazi gjinore që garantojnë pjesmarrje të barabartë në jetën publike dhe mbrojtje nga cdo formë diskriminimi.

Ligji për barazi gjinore është në linjë të plotë me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Femrës (CEDAË). Ky ligj garanton përfaqësim të barabartë gjinor prej 50% për secilën gjini, në të gjitha organet legjislative, gjyqësore, ekzekutive dhe organe të tjera publike. Poashtu, artikulli 1.5 i nenit 5 mbi masat e përgjithshme për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe sigurimin e barazisë gjinore, parasheh:

*“përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve.”<sup>5</sup>*

Ndërkaq, mekanizmi kryesor institucional që derivon nga ky ligj dhe që ka për qëllim identifikimin dhe hartimin e politikave që promovojnë barazinë gjinore dhe monitorojnë atë është Agjencia për Barazi Gjinore (Agjenci) në kuadër të zyrës së Kryeministrit. Kjo Agjenci ka përgatitur Programin Kombëtar për Barazi Gjinore (2020-2024) i cili ka për qëllim që të sigurojë që barazia gjinore të jetë në qendër të të gjitha proceseve transformuese në Kosovë, strukturave, proceseve, politikave, ndër të tjera. Sipas këtij programi, në Kosovë nuk ka zbatim të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor edhe pse parashihet me Ligjin për barazi gjinore. Pra, buxheti i përgjegjshëm gjinor mbetet vetëm në nivel raportimi tek institucionet, por ato nuk bëjnë ndarjen e resurseve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e të dy gjinive. Poashtu, ky ligj për barazi gjinore obligon të gjitha komunat dhe ministritë që të caktojnë zyrtarët përkatës për barazi gjinore me kapacitete profesionale dhe të ndajnë burime të mjaftueshme nga buxheti për funksionim. Këta zyrtarë, sipas nenit 12, artikulli 2.2 kanë detyrën dhe përgjegjshmërinë të bëjnë përfshirjen e integritit gjinor dhe buxhetimit në hartimin dhe zbatimin e politikave.

---

<sup>4</sup> Gazeta e Zyrtare e Republikës së Kosovës s. Amendamentin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës s. E qasshme tek <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=31730>

<sup>5</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës s. Ligji për barazi gjinore. Neni 5. artikulli 1.5

Si përfundim, sipas raportit të shtetit, korniza ligjore në Kosovë garanton mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut dhe është në linjë me standardet evropiane.<sup>6</sup> Por, në praktikë një pjesë e madhe e kornizës ligjore nuk zbatohet në plotni duke përfshirë këtu integrimin gjinor në politika, perkatesisht buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.

## Metodologjia

Për përgatitjen e kësaj analize gjinore në komunën e Lipjanit kemi aplikuar metodën 4R e cila përfshinë katër elementet e mëposhtme:

- (1) Reprerentimi (representation): Tek reprerentimi është analizuar nëse ka pasur një vlerësim të nevojave, si dhe nëse ka pasur paritet gjinor në dy aspekte të rëndësishme siç është vendimarrja dhe planifikimi.
- (2) Burimet (resources): Tek burimet është analizuar sesi janë shpenzuar ato resurse financiare në komunë për të vlerësuar nëse ka (pabarazi) në ndarje të buxhetit.
- (3) Realiteti (realia): Tek realiteti analizohet nëse ka integrim të çështjeve gjinore në intervenim si dhe arsyet mbi pabarazitë ekzistuese.
- (4) Realizimi (realization): Tek realizimi analizohet se çfarë duhet të bëj institucioni përkatës në mënyrë që të përmirësohet gjendja. Konkretisht, analizohet se si mund të ndryshoj ai interventim që të ketë përfshirje gjinore duke ofruar një numër të rekomandimeve.

Për të aplikuar këtë metodë është bërë hulumtim nga zyra dhe kontakt direkt me zyrtaren për barazi gjinore si dhe drejtorinë përkatëse. Të gjitha të dhënat e paraqitura dhe të analizuarat janë pranuar përmes email-it pas komunikimit të vazhdueshëm me zyrtarët komunal në Lipjan. Ndërkaq, hulumtimi nga zyra përfshin analizimin e kornizës legjislative dhe obligimet që dalin nga ajo, dhe mekanizmat institucional për barazinë gjinore në Kosovë.

## Komuna e Vitisë: Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari

Me poshtë vlerësohet nëse është bërë integrimi i perspektives gjinore ne politikat bujqesore të komunës, përmes katër shtyllave të 4R: reprerentimi, resurset, realia dhe realizimi.

### Reprerentimi

Në këtë seksion analizohet reprerentimi, pra në çfarë niveli ka paritet gjinor në planifikim dhe vendimarrje.

Së pari, në komunën e Vitisë, Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari është përgjegjëse për planifikim dhe koordinim të politikave në këtë fushë. Andaj, fillimisht është e rëndësishme që gratë të jenë të përfshira në ciklin e parë të zhvillimit të politikave, pra vendosjen e politikave në agjendë të komunës dhe zhvillimin e politikave bujqesore. **Sic shihet në tabelën e mëposhtme, trendi i punonjësve në këtë drejtori ka qenë cdoherë në disfavor të grave. Kjo reflekton mos-përfshirje të grave në zhvillim, koordinim, dhe vendimarrje të politikave bujqesore në nivel të komunës.** Edhepse me Ligjin për Barazi Gjinore, kërkohet që të ketë

---

<sup>6</sup> Raporti i Kosovës, 2022. Komisioni Evropian. E qasshme tek [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2022\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2022_en)

përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave në të gjitha nivelet vendim-marrësë dhe neni 3.1.15 përkufizon përfaqësimin e barabartë si jo më pak se 50% të njërës gjini. Pra, pavarësisht kërkesës ligjore për përfaqësim të barabartë, gratë mbesin të nënpërfaqesuara në këtë drejtori, pra në vitin 2013 ato përbëjnë rreth 23% të stafit të kësaj drejtorie. Por, sipas kësaj drejtorie, numrin e meshkujve në këtë drejtori e rrit divizioni i pylltarisë pasi që aty shumica janë roje të pyllit -meshkuj, ndërkaq divizioni i bujqësisë ka 3 femra dhe 2 meshkuj.<sup>7</sup>

Tabela 1. Të dhënat mbi punonjësitë në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pylltarisë<sup>8</sup>

Të dhënat mbi Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pylltarisë					
2021		2022		2023	
Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra
2	10	2	10	3	13

Së dyti, dy komisionet vlerësues të themelura gjatë vitit 2023 për vlerësimin e aplikuesve për furnizim me fidane të arres chandler dhe për përzgjedhjen e aplikuesve për furnizim me multikultivator, janë të për bëra nga 3 anëtarë, dy të gjinisë femërore dhe një i gjinisë femërore. **Pra, komisioni vlerësues si mekanizëm shumë i rëndësishëm vendimarrës ka përbërje gjinore që është shumë positive drejt integritit të perspektivës gjinore. Ndërkaq, thirrjet publike nuk kanë të integruar gjuhën e ndjeshme gjinore si dhe masa afirmative.**

#### Resurset

Në këtë seksion do të analizojmë dy kategori ekonomike nga perspektiva gjinore: (1) pagat dhe mëditjet dhe (2) subvencionet buxhetore nga perspektiva gjinore për të vlerësuar nëse gratë dhe burrat e komunës së Lipjanit janë duke përfituar njësoj nga këto subvencione. Kjo analizë përfshinë periudhën kohore 2021-2023.

Së pari, sic shihet në tabelën e mëposhtme shuma totale e pagave është rritur në vitin 2023, e poashtu janë shtuar edhe dy punonjëse, një e gjinisë femërore dhe një i gjinisë mashkullore. Meqë numri më i madh i punonjësve është burra, natyrshëm edhe shuma më e madhe e parave nga kjo kategori ekonomike ndahet për burra. Ndërkaq arsyjet për numër kaq të vogël të grave të punësuar në këtë drejtori mund të jenë të ndryshme duke përfshirë normat gjinore dhe perceptimi se kjo punë është më shumë për burra.

Tabela 2. Të dhënat mbi pagat<sup>9</sup>

N r.	DBPZHR-VITI	Total për paga i	Nr. i punëtorëve	Nr. i femrave	Paga	Nr. i meshkujve	Paga
------	-------------	------------------	------------------	---------------	------	-----------------	------

<sup>7</sup> Informatë përmes email-it nga Fadile Demelezi, Drejtorja për Bujqësi dhe Pylltari.

<sup>8</sup> Për sqarim: Edhe pse emërtimi është Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë, me kërkesë të drejtorit të kësaj drejtorie, nuk përfshihen të dhënat për divizionin e pylltarisë me arsyetimin se ky division është duke u transferuar në nivel qendror dhe aty dot vazhdojë të funksionojë vetëm drejtoria e bujqësisë. Andaj edhe numri 4 i punonjësve i përket vetëm atyre të divizionit të bujqësisë.

<sup>9</sup> Në mungesë të të dhënave mbi mëditjet, këtu paraqiten vetëm të dhënat mbi pagat

1	<b>Buxheti 2023</b>	67,600€	13	3	23092.07€	10	53,948.95€
2	<b>Buxheti 2022</b>	56,889.48€	12	2	12,331.2€	10	43,921.44€
3	<b>Buxheti 2021</b>	61,252.37€	12	2	12,331.2€	10	43,921.44€

Së dyti, të dhënat mbi subvencionet nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë përgjatë tri viteve të fundit paraqesin një pabarazi të theksuar në ndarjen e tyre. Sipas të dhënave në tabelën e mëposhtme që nga viti 2021 kemi një trend të rrëniës së subvencioneve të fituara në disfavor të grave. Pra, në vitin 2021 ato kanë përfituar 44%, në vitin 2022 kjo shifër ka rrënë në 29% dhe në vitin e fundit gratë kanë përfituar vetëm 14% të subvencioneve në bujqësi. **Kjo ndarje reflekton një pabarazi të thellë në shpenzimin e parave publike dhe i kontribuon përjetësisht sistematik të diskriminimit gjinor në bujqësi. Kjo pabarazi poashtu vështirëson fuqizimin ekonomik të grave dhe pavarësinë e tyre ekonomike, ndërkaq përkeqëson pabarazitë ekzistuese, duke përforcuar një cikël përjashtimi dhe privimi.** Për më shumë, shpalljet publike për subvencione nuk përbëjnë asnjë masë afirmative.

Tabela 3. Subvencionet për gra dhe burra (2021-2023)

Shuma e shpenzuar për subvencione (në Euro)		
Viti	Gra	Burra
<b>2021</b>	22,249 (44%)	28,023
<b>2022</b>	63,143 (29%)	150,950
<b>2023</b>	24,556 (14%)	146,244

Për të analizuar tutje, është me rëndësi të dijmë numrin e aplikueseve sipas gjinisë, për ta krahasuar me numrin e përfitueseve. Ndër vite vërejmë një trend të rritjes së numrit të aplikuesve nga 341 në vitin 2021 në 1380 në vitin 2023. Ndërkaq që numri i femrave fermere aplikuese ka rrënë ndjeshëm në vitin e fundit pavarësisht rritjes së numrit të përgjithshëm të aplikuesve. Poashtu, ndjeshëm ka rrënë edhe numri i femrave fermere përfituese nga 34% (2021) në 12% vitin e fundit (2023). Në përgjithësi, numri i meshkujve fermer që kanë aplikuar për subvencione është shumëfish më i madh sesa i femrave fermere, andaj kjo është edhe një arsye pse numri i përfituesve të tyre është më i madh. Mirpo, në përgjithësi, këto të dhëna vëjnë në pah rëndësinë e identifikimit të aktiviteve dhe iniciativave që ndihmojnë gratë të merren me bujqësi dhe të aplikojnë për subvencione të tilla.

Tabela 4. Numri i aplikueseve dhe përfitueseve sipas gjinisë përgjatë viteve

Vitet (tek këto të dhëna përfshihen të gjitha llojet e subvencioneve)	Nr. i aplikuesve	Nr. i femrave aplikuese	Nr. i përfituesve	Nr. i femrave përfituese	Nr. i meshkujve përfitues

nga kjo drejtori brenda një viti)					
<b>2021</b>	341	<b>126 (36%)</b>	<b>155</b>	<b>54 (34%)</b>	101
<b>2022</b>	970	<b>228 (23%)</b>	<b>578</b>	<b>126 (21%)</b>	452
<b>2023</b>	1380	<b>215 (15%)</b>	<b>471</b>	<b>57 (12%)</b>	414

Pra, komuna i mban të dhënat e ndara sipas gjinisë për aplikues dhe përfitues të subvencioneve. Por, cilat janë shpenzimet e komunës për kokë banori? Në tabelën e mëposhtme, duke marrë parasysh numrin e popullësisë sipas gjinisë në komunën e Vitisë dhe subvencionet e dhëna për të dy gjinitë, shihet se komuna ka ndarë më shumë subvencione për kokë banori burrë krahasuar me grua. Ky dallim është shumëfish më i madh në vitin e fundit, pra 617 Euro për burra krahasuar me 105 për gra.

Tabela 5. Shpenzimet e komunës për kokë banori

Viti	Për kokë banori (burrë)	Për kokë banore (grua)
<b>2021</b>	118 €	95 €
<b>2022</b>	636 €	271 €
<b>2023</b>	617 €	105 €

## Realia

Tek ky seksion është e rëndësishme që të analizojmë arsyjet e kësaj pabarazie të theksuar në ndarjen e parasë publike në bujqësi. Së pari, rregullorja komunale për ndarjen e subvencioneve i trajton burrat dhe gratë njësoj duke mos përfshirë asnjë masë afirmative si dhe duke mos ofruar asnjë pikë shtesë për gra në shpalljet e tyre publike edhe pse fermerët e gjinisë mashkullore vazhdojnë të përfitojnë shumëherë më shumë se gratë nga këto subvencione. Por, një problem i identifikuar këtu është edhe numri i vogël i fermereve të gjinisë femërore që aplikojnë, andaj është me rëndësi që komuna të merr masa për incentivimin e grave që të mirren me bujqësi dhe të aplikojnë për subvencione, për një zhvillim të qëndrueshem dhe avancim të barazise gjinorë në shoqërinë tonë.

Në anën tjetër, arsye të ndryshme socio-kulturore mund të ndikojnë në masë të ndryshme në pjesëmarrje të ulët të grave në aktivitete bujqësore. Ndër më të rëndësishmet përfshijnë akses jo-të barabartë në pronësi të pronës, e në vecanti tokës bujqësore. Në Kosovë, gratë vazhdojnë të mbesin në përqindje shumë të vogël (4.9%) si pronare të tokave. Poashtu, sikurse edhe në të gjithë botën, gratë në Kosovë kanë në përgjegjësi të tyre pjesën më të madhe të punëve të papaguara rreth shtëpisë, fëmijëve, dhe me të vjetërve në familje. Konkretisht, gratë shpenzojnë 44% më shumë kohë në punë të papaguar krahasuar me burra.<sup>10</sup> Kjo padyshim që kufizon kohën e tyre për tu marr edhe me punë tjera të paguara jashtë shtëpisë. Për më shumë, vazhdon të ekzistoj perceptimi se bujqësia, pylltaria dhe

<sup>10</sup> Instituti Musine Kokalari, 2022



zhvillimi rural janë më shumë punë me te cilat duhet të mirren burrat, e jo gratë. Kjo paraqet pengesë sa sociale po aq edhe psikologjike për pjesmarrjen e grave në këto aktivitete ekonomike.

## Realizimi

Në këtë seksion paraqiten disa rekomandime konkrete për të integruar aspektin gjinor në zhvillimin dhe implementimin e politikave bujqësore në komunën e Vitisë. Disa nga objektivat, akvitetet dhe indikatorët për tu ndërmarrë nga komuna janë si në vijim:

### Objektiva gjinore:

- Rritja e përqinjes së grave të cilat përfitojne nga subvencionet në bujqësi.
- Rritja e numrit të grave në drejtorinë për bujqësi dhe pylltari në mënyre që të ketë gjithëpërfshirje në planifikim dhe vendimarrje të politikave.

### Aktivitetet:

- Të ngriten kapacitetet e grave për të përdorur paisje bujqësore si freza spërkatëse dhe të tjera mjete motorike.
- Të vendoset ndonjë masë afirmative në thirrjen publike për subvencione.
- Të këtë fushatë ndërgjegjësimi për gra në lidhje me mundësinë për aplikim për subvencione në bujqësi.
- Të integrohen objektiva dhe indikatorë sensitive gjinor në Kornizën Afatmesme Buxhetore të ardhshme.
- Të integrohet një masë afirmative në shpalljet e ardhshme për punë nga kjo drejtori në mënyrë që të motivohen gratë të aplikojnë.

### Indikatorë gjinor:

- Rritja e përqindjes së grave që përfitojnë nga subvencionet në bujqësi nga 14% në 24% gjatë vitit 2024.
- Rritja e numrit të grave që punojnë në drejtori të bujqësisë nga 3 në 4 gjatë vitit 2024.

P.S Analiza është bërë në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zyrtaren për Barazi Gjinore